



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Në bazë të Nenit 3 pika 7 dhe të Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (LSHCRK), përkatësisht të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

K O N K U R S

II. Titulli i vendit të punës: Përkthyes serbisht – shqip - serbisht (Një pozitë)

Referenca: IAP – 2/2014

Paga-koeficienti: 11,30

Mbikqyrësi: Drejtori i Administratës

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar, peruudha provuese 12 muaj.

Vendi i punës është i rezervuar për individë me gjuhë amtare serbe.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të përkthejë në mënyrë profesionale materialet dhe dokumentet e ndryshme,
- Të përkthejë në mënyrë gojore gjatë intervistave, takimeve, konferencave, seminareve dhe trajnimeve, brenda dhe jashtë hapësirave të IAP,
- Të sigurojë përdorimin e terminologjisë ligjore që përdoret në njësinë e përkthimit,
- Të mbajë, rregullojë dhe mbikëqyrë shënimet në lidhje me shërbimet e ofruara nga ana e njësisë së përkthimit dhe të mbajë statistikën e dokumenteve të përkthyer,
- Të kryejë detyra tjera të cilat mund t'i caktohen nga eprori i tij/saj.

Përgatitja profesionale, kualifikimi, aftësitë dhe karakteristikat tjera:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje superiore ose të lartë shkollore në lëmin e gjuhësisë, e obligueshme.
- Njohja e gjuhës serbe dhe shqipe me shkrim dhe në të folur, e obligueshme,
- Njohje e programeve kompjuterike të Microsoft Office dhe të internetit, e obligueshme,
- Dy (2) vite përvojë pune në administratë apo në arsim, e obligueshme,
- Gatishmëri e lartë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multigjuhësore,
- Gatishmëri për të punuar nën presion kohor, në rrethana të jashtëzakonshme dhe jashtë orarit të punës.
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale (jo më i vjetër se 6 muaj) – i obligueshëm.

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

[Formularët për punësim](#) mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen e internetit: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim mund të dorëzohen personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Enver Maloku“, nr. 28, Bregu i diellit, 10 000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa asnjë dallim.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të numrit të madh të aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 14 mars 2014.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim, dhe ato të pakomletuara nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038 223 782

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar por, nuk janë zgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit, gjegjësisht 90 ditë nga momemnti i skadimit të afatit të aplikimit. Dokumentet që nuk tërhiqen asgjësohen.